



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 578/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e organizatës së Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REUZOHET** ankesa si e pabazuar e organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga organizata BIRN, me te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në ora 16:30 në fshatin Zhur komuna e Prizrenit, në Qendrën e Votimit (QV) nr. 2033a Vendvotimi (VV) 05R, kanë qenë prezent katër vëzhgues nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës thekson se në rastin konkret është bërë shkelje e nenin 57 paragrafi 3 i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

*Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar dëshmi për të besuar se me datë 12.12.2010, në QV nr. 2033a, VV 05R, fshati Zhur komuna e Prizrenit, ka pasur prezent katër vëzhgues të PDK-se. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 578/2010 më datën 15.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

